



Najrudin Zekaj


Zekaj



Albena Breshkaj

Albena Breshkaj

Artemida Ducej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2536 / Prot.

3

Vlorë më, 06.11.2024

VENDIM

Nr. 52, datë 31.10.2024

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË RI STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË BACHELOR,
NË "MATEMATIKË INFORMATIKË" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh , nenit 71,73,74, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Matematikës dhe Fizikës, si dhe relacionit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2428, prot, datë, 28.10.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Matematikës dhe Fizikës, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Matematikë - Informatikë", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe Drejtoria e Edukimit e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

A. Saliaj

